Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 246
DAT.DT. 27 . 04. 2021
PRISHTINË - A

ROLAG
ADVISORY GROUP FOR RULE OF LAW

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICAL COUNCIL

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

ndërmjet

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe/ose Gjykata Supreme,

dhe

Grupi Këshillëdhënës për Sundim të Ligjit,

në zbatim të projektit

"Mbështetje për themelimin e zyrës për rikuperimin e pasurive dhe krijimin e qendrës burimore"

DUKE KONSIDEUAR këtë memorandum si shprehje të vullnetit të dyanshëm në mes të OJQ-së RoLAG me seli në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës/Gjykatës Supreme për Implementimin e Projektit: mbështetje për themelimin e zyrës për rikuperim të pasurive dhe krijimin e qendrës burimore (më tutje Projekti) si grant që i është shpërblyer OJQ-së ROLAG me seli në Prishtinë nga Zyra e UNDP-së ne Kosovë në kuadër të Projektit SAEK III që ka të bëj me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

DUKE DITUR se përmes këtij Memorandumi synohet të intensifikohet bashkëpunimi~~n~~ i ndërsjellë dhe ngritjes së efikasitetit në politikën ndëshkimorë në Kosovë, si një mjet efikas në politikat anti-korrupsion,

BAZUAR në legjislacionin në fuqi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje: KGJK) dhe/ose Gjykata Supreme, në njërën anë, dhe tutje: Grupi Këshillëdhënës për Sundim të Ligjit (më tutje: RoLAG), bashkërisht të cilësuara si palët nënshkruese, pajtohen si me poshtë:

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është themelimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve nënshkruese me qëllim që të bëhet sa më i lehtë implementimi i projektit me qëllim të ngritjes së besueshmërisë së publikut dhe palëve ndërgjyqës në sistemin gjyqësor të Kosovës.

2. Obligimet e palëve

Palët nënshkruese obligohen që t'i përmbahen kushteve të parapara në këtë Memorandum dhe që në mirëbesim të veprojnë në funksion të zbatimi të projektit.

3. Obligimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës/Gjykatës Supreme

3.1 Të mundësoj qasje në aktgjykimet penale me qëllim të monitorimit në lidhje me sanksionet në raport me zbatimin e udhëzuesit / udhëzuesve për politikat ndëshkimore.

3.2 Të bashkëpunojnë ngushtë në funksion të monitorimit të zbatimit të politikave ndëshkimore që dalin nga ky memorandum.

3.3 Të mundësojë që në mënyrë efikase dhe pa vonese të i jepen në dispozicion Organizatës RoLAG aktgjykimet penale me veprat penale nga Kodit Penal - Kapitull kundër Korrupsionit.

3.4 Të caktojë zyrtarët në gjykatë të cilët do të bëjnë ndarjen e aktgjykimeve në zyrtarët e organizatës RoLAG.

3.5 Të bashkëpunojë me zyrtarët e organizatës në definimin e qartë të termave të referencës për njësitin që do të themelohet në funksion të ndihmës së dhënë Komisionit Këshillues për Politikë Ndëshkimore.

4. Obligimet e OJQ RoLAG

4.1 Të ruaj në konfidencialitet të plotë të dhënat e palëve dhe të dhënat tjera konfidenciale të pranuar në lidhje me aktgjykimet.

4.2 Të përpilojë raporte tre mujore me rastet e pranuar në lidhje me monitorimin e zbatimi të politikës ndëshkimore.

4.3 Të bëj rekomandime në lidhje me gjetjet gjatë monitorimit sistematik të politikës ndëshkimore.

4.4 Të delegojë, sipas kërkesës, zyrtar të organizatës në Gjykatën Supreme të Kosovës.

5. Përgjegjësitë e palëve

5.1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Supreme nuk mbanë përgjegjësi rreth implementimit të këtij Projekti, përveç obligimeve të shprehura nga Neni 2 dhe 3 të këtij Memorandumi.

5.2 OJQ RoLAG është përgjegjëse që gjatë implementimit të Projektit mos të shkaktohen situata që pengojnë mbarëvajtjen e proceseve të punës në gjykata.

5.3 Gjatë implementimit të aktiviteteve tjera të Projektit, OJQ RoLAG ka përgjegjësinë që të ftojë drejtuesit e Gjykatës Supreme dhe Komisionin Këshillëdhënës për Politika Ndëshkimore, sikur është organizimi i tryezave të rrumbullakëta për të diskutuar të gjeturat dhe harmonizuar rekomandimet sa më relevante për të përmirësuar situatën.

5.4 Në fund të Projektit, OJQ RoLAG do t'i dërgojë Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatës Supreme, një kopje të shtypur dhe një elektronike (CD) të Raportit përfundimtar me të gjetura dhe rekomandime nga aktivitetet monitoruese dhe të diskutimeve tjera.

6. Implementimi dhe Amendamentimi

6.1 Implementimi i këtij Memorandumi do të monitorohet nga Menaxheri i projektit - Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së ROLAG dhe Kryetari I Gjykatës Supreme.

6.2 Ky Memorandum i Mirëkuptimit mund të ndryshohet apo plotësohet sipas marrëveshjeve të arritura me shkrim midis palëve.

6.3 Ndryshimet dhe plotësimet bëhen pjesë përbërëse e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

7. Periudhe e zbatimi te këtij Memorandumi

7.1 Periudha implementuese e këtij Projekti është prej ditës së nënshkrimit deri me 30 qershor 2024.

7.2 Ky Memorandum do të shërbej si lidhje afatgjate e Partneritetit në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, respektivisht Gjykatës Supreme dhe OJQ-së ROLAG me qëllimin e përbashkët për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe ndërtimin demokratik përmes një gjyqësie të pavarur dhe të drejtë me pjesëmarrje qytetare.

8. Zbatim i Memorandumit

8.1 Çdo çështje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij MiM do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve mes palëve nënshkruese.

8.2 Në rast se nevojitet të nënshkruhet ndonjë akt tjetër mirëkuptimi në mes palëve të këtij Memorandumi për projekte dhe aktivitete tjera, aktet e nënshkruara do të i bashkëngjitën si aneks Memorandume këtij Memorandumi, duke specifikuar kushtet dhe qëllimet e aneks Memorandumit të ri.

8.3 Çfarëdo plotësimi apo ndryshimi i këtij Memorandumi do të bëhet duke u dakorduar me shkrim dhe do të pranohet nga palët nënshkruese në formën e duhur.

8.4 Asnjëra palë nuk do të caktojë, transferojë, premtojë ose të bëjë dispozita të tjera të të drejtave sipas këtij Memorandumi ose të ndonjë pjese të tij, përveç me pëlqimin paraprak me shkrim të te gjitha palëve nënshkruese.

8.5 Ky Memorandum i Mirëkuptimit është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

8.6 Memorandumi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Palët nënshkruese

OJQ ROLAG

Flakrina Osmani

Koordinator i Projektit

Drejtor Ekzekutiv OJQ-së ROLAG

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Skender ÇOÇAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, 27. 04. 2021